



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/772  
Datë: 10/12/2018

Këshilli drejtues në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 10.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

Këshillit Drejtues, lidhur me verifikimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të Parlamentit të studentëve të Certifikuar nga KQZ në mbledhjen konstituive të datës 06.07.2018, konstatoj:

1. Për të ardhur deri te verifikimi i saktë i mandateve të cilat janë kërkuar të zëvendësohen në përputhshmëri me nenin 2 paragr.6 të Rregullores për konstituimin dhe punën e Parlamentit të studentëve dhe Këshillave të studentëve në Universitetin e Prishtinës nr. 1/64, dt. 20.4.2018, ka përdorur këto prova:
  - Audio incizimin e mbledhjes konstituive të mbajtur me datë 06.07.2018 dhe
  - Ekstraktin nga mbledhja konstituive e datës 06.07.2018.
2. Me këtë rast u konstatua se në mbledhje gjatë verifikimit të prezencës ishin të pranishëm anëtarët, si në vijim:
  1. Rrezon Frangu,
  2. Vesel Kuqi,
  3. Melos Kolshi,
  4. Elas Morina,
  5. Rilind Sylaj,
  6. Arben Elshani,
  7. Edon Nishori,
  8. Liridona Mazreku,
  9. Flakron Kabashi,
  10. Rilind Maloku dhe
  11. Haris Ademi.
3. Këshilli drejtues në mbledhjen e datës 06.12.2018 ka marr vendim për zëvendësimin e anëtarëve të cilët në mbledhjen konstituive gjatë verifikimit të prezencës, nuk kanë qenë të pranishëm. Neni 2, paragrafi 6 i Rregullores për konstituimin dhe punën e Parlamentit të studentëve dhe Këshillave të studentëve në Universitetin e Prishtinës nr. 1/64, dt. 20.4.2018, parasheh si në vijim: "Asnjë mandatar nuk guxon të mungoi në mbledhjen konstituive të PS/KS. Mungesa nga mbledhja konstituive nënkupton heqje dorë nga mandati. KQZ/KZF do të zëvendësoj mandatarin i cili ka munguar në mbledhje konstituive me studentë pasues në listën e kandidatëve të organizatës studentore".
4. Bazuar në vendimmin e Këshillit Drejtues nr. 4/737, dt. 6.12.2018, 6 anëtarë të certifikuar të Parlamentit të studentëve të cilët nuk kanë qenë prezent në mbledhje

konstituive me datë 06.07.2018, me datë 07.12.2018 janë zëvendësuar me kandidatë pasues nga lista e kandidatëve të certifikuar të Organizatave përkatëse dhe atë si në vijim:

1. Bledian Geci
  2. Hata Bela
  3. Patriot Mehmeti
  4. Fahredin Thaçi
  5. Albert Shala
  6. Drinor Mecinaj.
5. Këshilli drejtues i UP-së, konstaton se valide merren listat e kandidatëve të certifikuara nga KQZ dhe të verifikuara në përputhje me nenin 27 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve nr. 1/63, datë 20.4.2018.
6. Kryesuesi aktual i Parlamentit të studentëve, obligohet që me datë 11.12.2018, në ora 14:00, të mbaj mbledhjen e Parlamentit të studentëve. Mbledhja do të mbahet në sallën e Senatit të UP-së, me këtë Rend dite:
1. Nënshkrimi i deklaratës etike të mandatrëve të zëvendësuar,
  2. Mocioni i votëbesimit për kryetarin,
7. Në rast se kryesuesi aktual i Parlamentit të studentëve, nuk e respekton këtë vendim, mbledhja do të mbahet në të njëjtën ditë në ora 14:30 dhe do të kryesohet nga Këshilli drejtues i UP-së, me pikat e rendit të ditës si në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli drejtues.

Ky vendim i'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Kryetarit të PS,
3. Organizatave studentore të përfaësuar në PS,
4. Menaxhmentit të UP-së,
5. Kryesuesit të KQZ-së.



Këshilli drejtues të UP-së,  
Mr. Ardiana Bunjaku, Kryesuese